

## **POLITIKA E PRIVATËSISË**

Banka ProCredit SH.A. është kontrollues i të dhënave personale që jepen nga individët kur shfrytëzojnë shërbimet që ne ofrojmë, qoftë përmes marrëdhënies së biznesit apo përmes pranisë online, kur përdorin faqen e internetit të bankës, shërbimin e-banking në internet dhe aplikacionin e bankës në celular.

Në vijim në tekst, termat "Banka" dhe "ne" dhe ato që rrjedhin prej tyre i referohen Bankës ProCredit SH.A. (me seli në Rrugën Dritan Hoxha, pranë pallatit të sportit "Asllan Rusi", 1026, Tiranë, Shqipëri). Termi "ju" dhe ata që rrjedhin prej tij i referohen përdoruesve të shërbimeve tona. Termi "Politika e privatësisë" i referohet këtij dokumenti. Termi "faqe web-i", "faqe interneti" i referohet faqes zyrtare të bankës <https://www.procreditbank.com.al/>, termi "e-banking në internet" i referohet <https://ebanking.procreditbank.com.al/User/LogOn> dhe "app" i referohet aplikacionit të Bankës ProCredit në App Store/Play Store.

Politika e privatësisë ju informon për kontrollimin, përpunimin dhe transferimin e të dhënave personale. Rregullat e paraqitura në këtë dokument vlejnë për çdo formë të të dhënave, qoftë të ruajtura elektronikisht, në letër apo në ndonjë paisje tjetër ku ruhen të dhënat.

Kontrollues për qëllimet e Ligjit Nr.124, datë 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe aktet nenligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave, është Procredit bank Sh.a.

ProCredit Bank sh.a ka emëruar një person përgjegjës për çështjen e të dhënave personale. Të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në Bankë janë si më poshtë:

Z. Emiljan Dyrmishi

Numër kontakti: +355 (4) 2 389 389

E-Mail: [alb.dpo@procredit-group.com](mailto:alb.dpo@procredit-group.com)

Adresa: ProCredit Bank Sh.A (Shqipëri)

Rr.Dritan Hoxha, pranë pallatit të sportit "Asllan Rusi", 1026, Tiranë, Shqipëri.

[www.procreditbank.com.al](http://www.procreditbank.com.al)

[kujdesindajklientit@procredit-group.com](mailto:kujdesindajklientit@procredit-group.com) ose [informacion@procredit-group.com](mailto:informacion@procredit-group.com)

## Përmbajtja

|                                                                                                                         |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Parimet e mbrojtjes së të dhënave .....                                                                              | 3  |
| 2. Përkufizimet .....                                                                                                   | 3  |
| 3. Cilat të dhëna personale përpunon Banka? .....                                                                       | 4  |
| 4. Si i mbledh Banka të dhënat tuaja personale? .....                                                                   | 4  |
| 5. Cilat janë qëllimet e përpunimit të të dhënave? .....                                                                | 5  |
| 5.1 Vendimmarrja dhe profilizimi i automatizuar .....                                                                   | 5  |
| 6. Cila është baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale? .....                                                 | 6  |
| 7. Si i përpunon Banka të dhënat tuaja personale? .....                                                                 | 6  |
| 7.1. Transferta me telefon .....                                                                                        | 7  |
| 7.2. Autentifikimi biometrik .....                                                                                      | 7  |
| 7.3. Burimet Njerëzore .....                                                                                            | 8  |
| 7.4. Regjistrimet e thirrjeve telefonike .....                                                                          | 8  |
| 7.5. Setet e anonimizuara të të dhënave .....                                                                           | 8  |
| 7.6. Mundësitë e financimit të gjelbër .....                                                                            | 8  |
| 7.7 Referimi i Klientit .....                                                                                           | 9  |
| 7.8 Pagesat Contactless .....                                                                                           | 9  |
| 8. Cilat janë të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave? .....                                                        | 9  |
| 9. Çfarë janë kërkesat për akses të subjektit të të dhënave? .....                                                      | 10 |
| 10. Kur mund t'i transferojë Banka të dhënat tuaja personale? .....                                                     | 10 |
| 11. Cila është periudha për ruajtjen e të dhënave personale ose kriteret për përcaktimin e periudhës së ruajtjes? ..... | 11 |
| 12. Çfarë janë cookies? .....                                                                                           | 12 |
| Cookies të nevojshme .....                                                                                              | 12 |
| Cookies të performancës .....                                                                                           | 12 |
| Cookies funksionale .....                                                                                               | 12 |
| Reklamimi .....                                                                                                         | 12 |
| 12.1 Çfarë lloj të të dhënave dhe informatave të përgjithshme mbledh Banka? .....                                       | 12 |
| 12.2 Përse Banka përdor cookies dhe mbledh të dhëna dhe informacion të përgjithshëm? .....                              | 13 |
| 12.3 Si mundën përdoruesit t'i menaxhojnë cookies? .....                                                                | 13 |
| 13. Google Analytics .....                                                                                              | 13 |
| 14. Përpunimi i të dhënave në komunikimin e informacionit .....                                                         | 14 |
| 15. Përditësimet e politikës së privatësisë .....                                                                       | 14 |

## 1. Parimet e mbrojtjes së të dhënave

Banka i përpunon të dhënat tuaja personale në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 124, datë 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", (këtu e më tutje në tekst: Ligji) dhe akte ligjore e nënligjore të tjera të zbatueshme në vend. Kjo gjë siguron që përpunimi i të dhënave personale kur kërkohen shërbime nga Banka është në përputhje me masat mbrojtëse dhe detyrimet ligjorisht të zbatueshme.

Banka është e përkushtuar ndaj përpunimit të të gjitha të dhënave personale nën kontrollin e vet në përputhje me parimet që kanë të bëjnë me përpunimin e tyre. Prandaj, të dhënat personale:

- Përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente
- Mblidhen vetëm për qëllime specifike, eksplicite dhe të ligjshme
- Janë të duhura, relevante dhe jo të tepërta sa i përket qëllimeve për të cilat përpunohen të dhënat
- Janë të sakta dhe ku është e zbatueshme, të përditësuara
- Ruhen për aq kohë sa është e nevojshme, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- Përpunohen nën masat e duhura të sigurisë duke respektuar integritetin dhe konfidencialitetin e tyre

Banka është e angazhuar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale brenda ambienteve dhe sistemeve të saj. Banka garanton që punonjësit e bankës dhe kompanitë që ofrojnë shërbime për Bankën janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me parimet e mbrojtjes së të dhënave. Banka deklaron se të dhënat e klientit nuk do të përdoren për qëllime të tjera përveç të dhënave që janë për t'u përdorur në kohën e mbledhjes së tyre apo qëllime që lidhen me ofrimin e produkteve dhe shërbimeve bankare në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ajo apo nëpërmjet shoqërisë së shërbimit postar si edhe të palëve të treta të tjera, të kontraktuara nga banka dhe që janë të të licencuara për kryerjen e shërbimeve përkatëse, në përputhje me legjislacionin vendas dhe atë të Bashkimit Europian. Këtu përfshihen edhe subjektet që kryejnë shërbime outsource për bankën, si psh: identifikimi dhe verifikimi në distancë në bazë të legjislacionit të zbatueshëm të BE dhe atij Shqiptar që është në fuqi në vendin tonë, dorëzimi i kartave nëpërmjet shërbimit postar, etj.

Klienti jep pëlqimin e tij që banka të përpunojë dhe transferojë të dhënat e tij, edhe tek palët e treta, për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë dhe është në dijeni që ky pëlqim mund të tërhiqet në çdo kohë duke lajmëruar bankën. Klienti jep pëlqimin e tij me vullnet të plotë dhe të lirë për kontrollin, përpunimin, transferimin e të dhënave të tij personale nga banka dhe palë të treta, për këtë qëllim por pa u kufizuar në të.

## 2. Përkufizimet

Për qëllime të politikës së privatësisë, vlejnë përkufizimet e gjendura në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale:

**"Të dhëna personale"** është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash.

**"Kontrollues"** është personi fizik ose juridik dhe çdo autoritet publik, i cili, vetëm ose së bashku me të tjerët, përcakton qëllimet e mjetet e përpunimit të të dhënave personale. Për përpunimin e të dhënave personale, sipas dispozitave të ligjit, kontrolluesi është autoriteti kompetent, i cili, vetëm ose së bashku me të tjerët, përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale.

**"Pëlqim"** është çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklarate ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshtimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike.

**"Përpunim"** është çdo veprim ose një grup veprimesh, që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në

ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi;

### 3. Cilat të dhëna personale përpunon Banka?

Banka përpunon të dhënat personale për të ofruar shërbimet e saj ose kur kjo kërkohet me ligj. Kategoria e të dhënave personale që do të përpunohen varet nga shërbimet e kërkuara dhe produktet që përdorin klientët. Për shembull, nëse dëshironi të caktoni takim me Bankën lidhur me shërbimet bankare, duhet të jepni emrin dhe mbiemrin tuaj, numrin e telefonit, adresën e email, numrin personal të identifikimit, vendlindjen, etj. Mirëpo, nëse dëshironi të hapni një llogari bankare, duhet të jepni më shumë të dhëna personale.<sup>1</sup> Kategoritë e të dhënave të cilat përpunohen nga Banka janë:

- Identiteti dhe kontaktet (emër, mbiemër, gjinia, shtetësia, arsimimi, adresa, emaili, dokumenti i identitetit, etj)
- Informacion financiar (Detaje për të ardhurat, historiku i kredisë, dokumentat e pronësisë, etj)
- Informacion lidhur me produktet dhe shërbimet që ofron Banka (Detaje të llogarive, kartave, transaksioneve, historiku, etj.)
- Informacioni teknik dhe identifikimi online
- Të dhëna penale, ne kuadër të vlerësimit të situatës ligjore të klientit, vlerësimit të aplikimeve për produkte kredie
- Lloje të tjera të të dhënave (Imazhe të kamerave të sigurisë, regjistrime zanore, të dhëna hetimore, ankesa, etj)

### 4. Si i mbledh Banka të dhënat tuaja personale?

Banka i mbledh të dhënat tuaja personale kryesisht kur ju përdorni shërbimet dhe produktet që ofrohen drejtpërdrejt në sportel ose në platformat tona online. Banka i mbledh të dhënat tuaja personale kur ju:

- Regjistroheni si klient dhe/ose hapni llogari bankare
- Aplikoni për ndonjë nga produktet ose shërbimet tona, si depozita me afat, kredi për shtëpi, kredi për investime etj.
- Përdorni shërbimet bankare si e-banking, m-banking, etj.
- Përdorni ose shikoni faqen e internetit të bankës përmes cookies të shfletuesit tuaj të internetit
- Vizitoni zyrat qendrore / agjencitë/degët e Bankës
- Kontaktoni me Bankën përmes email-it apo formularëve të kontaktit/ankesave (ose përmes telefonatave nëpërmjet Qendrës së Kontaktit ose kanaleve të tjera të komunikimit)
- Jepni informacion, me shkrim ose me gojë, përmes email-it, formularëve të qendrës së kontaktit, deklaratave noteriale, kontratave ose kanaleve të tjera të komunikimit.
- Kur aplikohet për praktike profesionale, pjesëmarrje në programin e punësimit apo për t'u punësuar pranë bankës.
- Kur merrni pranë bankës produkte bankare të tjera apo shërbime të ndryshme nga sa me sipër.

Banka mund të mbledhë të dhënat tuaja brenda kufizimeve të përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm. Të dhënat mund të merren edhe tërthorazi nëpërmjet subjekteve të tjera të grupit ProCredit, apo nga burime të tjera publike si psh:

- Regjistra publikë (p.sh. Regjistri i kredive nga Banka e Shqipërisë, Regjistrat publike të administruar nga QKB, Regjistrat e administruar nga ASHK, RBS, Regjistra të tjerë publike, etj)

<sup>1</sup> Banka përpunon të dhëna personale që kanë të bëjnë me fëmijët vetëm në përputhje me kërkesat ligjore dhe pasi ka marrë pëlqimin e prindit/ kujdestarit ligjor të tyre.

- Autoritetet publike dhe agjencitë e ngarkuara për zbatimin e ligjit
- Agjencitë e rekrutimit në rastet e punësimit të punonjësve, (nëse është rasti), etj.

Në çdo rast, të dhënat personale merren dhe përpunohen në përputhje të plote me përcaktimet e akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## 5. Cilat janë qëllimet e përpunimit të të dhënave?

Banka i përpunon të dhënat tuaja personale për të ofruar shërbimet dhe produktet e saj, si shërbime financiare/ bankare dhe shërbime të lidhura me to. Banka mbështetet tek një sërë bazash ligjore për përpunimin e të dhënave personale. Të dhënat personale përdoren për të:

- Përpunuar aplikimet e subjekteve të të dhënave për shërbime dhe produkte që ofron Banka (produkte kredie, llogari dhe shërbime të tjera).
- Përpunuar pagesat dhe transaksionet e tjera të bëra nga dhe/ose drejt subjekteve të të dhënave qoftë nëpërmjet mënyrave të ofruara nga vete banka apo nëpërmjet shërbimeve të tjera të njohura ligjërisht si p.sh: open banking.
- Përpunuar të dhënat në lidhje me përbushjen e detyrimeve kontraktuale për çdo produkt dhe shërbim bankar
- Ofruar shërbimet në kohë dhe produkte të cilësisë së lartë dhe në kohë
- Përbushur detyrimet ligjore dhe rregullative (si raportimi dhe reagimi ndaj kërkesave të Bankës së Shqipërisë, Institucioneve tatimore, Shërbimit Permbartimor, etj)
- Verifikuar identitetin e subjekteve të të dhënave fizikisht ose në distance nëpërmjet platformave online të certifikuara nga organet përkatëse, sipas legjislacionit të zbatueshëm
- Verifikuar vlerësimin e kredive
- Parandaluar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe mashtrimet
- Kontrolluar dhe raportuar detyrimet sipas kërkesave ligjore
- Përmirësuar shërbimin ndaj klientit dhe menaxhimin e marrëdhënies me klientët dhe studimin e tregut me anë të kërkimeve, analizave/anketave, promovimin e produkteve kryerjen e marketingut të drejtpërdrejt nga vete banka ose nga pale të treta, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
- Nxituri zhvillimin e biznesit Siguruar menaxhim të duhur të rrezikut kredisë, mjedisor, etj (sidomos rrezikun e kredisë)
- Mbrojturi interesat legjitime të Bankës (p.sh. mbikëqyrje me video, numërimi i fondeve, zgjidhja e ankesave të klientëve etj.)

### 5.1 Vendimmarrja dhe profilizimi i automatizuar

Banka, si rregull nuk e përdor profilizimin apo vendimmarrjen e automatizuar kur krijon marrëdhënie biznesi me subjektet e të dhënave. Por verifikimi i identitetit të klientit nëpërmjet përdorimit të teknologjisë dhe mjeteve të tjera elektronike, mund të kryhet në rastet kur ky proces kryhet në distance dhe pa praninë fizike të klientit në bankë. Gjithashtu, Banka mund të përdorë vendimmarrjen dhe profilizimin e automatizuar për të verifikuar individët, kompanitë dhe transaksionet e dyshimta, apo për të identifikuar pagesa që i nënshtrohen sanksioneve ndërkombëtare në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe mashtrimit. Megjithatë këto procese bazohen në përdorimin e mjeteve automatike, dhe zakonisht kërkojnë dhe përfshirjen e stafit përgjegjës në marrjen e vendimi final.

## **6.Cila është baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale?**

Banka i përpunon të dhënat tuaja personale ne menyre tel ligjshme nëse permbushet te paktën nje nga kriteret e mëposhtme:

- Subjekti i të dhënave e ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike. Në rast të tillë, përpunimi i të dhënave personale lejohet në bazën ligjore të pëlqimit, që është i revokueshëm në çdo kohë. Klientet mund ta tërheqin pëlqimin nepërmjet të njëjtës forme siç kane dhënë pëlqimin ose përmes kanaleve tona të kontaktit pa pagesë. Tërheqja e pëlqimit nuk cenon ligjshmërinë e përpunimit të bazuar në pëlqimin përpara tërheqjes së tij. Përpunimi i të dhënave personaleve të të miturit mbi bazën e dhënies së pëlqimit në kade të ofrimit të shërbimeve të drejtpërdrejta ndaj tij, është i ligjshëm nëse i mituri është mbi 16 vjeç. Kur i mituri është nën 16 vjeç, përpunimi është i ligjshëm vetëm kur pëlqimi jepet ose autorizohet nga prindi ose kujdestari i tij ligjor dhe për atë që jepet ose autorizohet prej tij.
- Përpunimi është i nevojshëm për zbatimin e kontratës ku subjekti i të dhënave është palë ose për të ndërmarrë hapa me kërkesë të subjektit të të dhënave përpara lidhjes së kontratës. Në këtë rast, përpunimi i të dhënave personale është i nevojshëm për të përmbushur detyrimet kontraktuale dhe parakontraktuale të kërkuara nga ju për të kryer shërbime financiare, transaksione bankare ose shërbime dhe produkte të tjera të Bankës.
- Përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimit ligjor të cilit i nënshtrohet Banka. Në këtë rast, përpunimi i të dhënave personale justifikohet me përmbushjen e kërkesave të Ligjit për "Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", i ndryshuar, legjislacioni tatimor, legjislacionit për shërbimin përmbartimor, detyrimeve të tjera ligjore dhe kërkesave rregullative të cilave u nënshtrohet Banka. Detyrime të tilla e autorizojnë Bankën të përpunojë të dhënat tuaja personale për të verifikuar identitetin tuaj, ndër të tjera, për të parandaluar pastrimin e parave dhe mashtrimin, vlerësimin e situatës tuaj financiare, raportimin e detyrimeve për shkak të ligjeve tatimore dhe vlerësimit të rrezikut.
- Përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër
- Përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen nga kontrolluesi të një detyre ligjore me interes publik ose kur atij i është dhënë e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike në bazë të legjislacionit në fuqi
- Përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e interesave të ligjshëm të kontrolluesit ose të një pale të tretë, me përjashtim të rastit kur interesat, ose të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave, që kërkojnë mbrojtje të të dhënave personale, veçanërisht kur subjekti i të dhënave është i mitur, kanë përparësi mbi këto interesa, me përjashtim kur përpunimi kryhet nga autoritetet publike në përmbushjen e detyrave të tyre. Në këtë rast, të dhënat tuaja personale përpunohen në baze të legjislacionit të zbatueshëm në vend me qëllim për të mbrojtur interesat legjitime të Bankës ose interesat legjitime të një institucioni pale e tretë, për të garantuar sigurinë e sistemeve të IT-së, për të parandaluar mashtrimin përmes përpunimit të të dhënave të pajisjes, për të parandaluar veprime kriminale, për menaxhimin dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve, menaxhimin e rrezikut brenda Grupit ProCredit,etj.

## **7.Si i përpunon Banka të dhënat tuaja personale?**

Banka i përpunon të dhënat në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente, në përmbushje të

kërkesave të ligjeve të zbatueshme duke ofruar mbrojtje nga përpunimi i paautorizuar ose i kundërligjshëm, dhe nga humbjet apo përhapjet aksidentale të të dhënave personale, duke përdorur masat e duhura teknike dhe organizative. Për çështjet e lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale, banka ka caktuar një person përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Data Protection Officer). Gjithashtu ne banka është caktuar dhe personi përgjegjës për Sigurinë e Informacionit.

Banka vë në zbatim masat e duhura teknike dhe organizative në atë mënyrë që realizon sigurinë më të lartë të mundshme, të përshtatshme për nivelin e rrezikut, në mënyrë që të mbrojtë të dhënat tuaja personale, për shembull duke përdorur mbrojtjen e pajisjeve dhe të të dhënave, kontrollin dhe të drejtat për akses, verifikimin e identitetit të përdoruesit etj. Banka sipas kërkesës së Klientit në çdo kohë mund të fshijë të gjitha të dhënat e tij personale<sup>2</sup> që janë mbledhur nga Banka, t'i korrigjojë ose përditësojë ato në përputhje me legjislacionin në fuqi. Banka është gjithashtu në dispozicion të Klientit në çdo kohë për çdo pyetje të mëtejshme mbi mbrojtjen e të dhënave dhe për mënyrën se si Banka përpunon të dhënat e Klientit dhe kush i përpunon këto të dhëna.

Banka mbledh dhe përpunon të dhënat tuaja gjatë hapjes së llogarisë në mënyrë digjitale, në distancë dhe pa pasur nevojë të vizitoni bankën. Kjo zgjidhje ofrohet nëpërmjet identifikimit në distancë dhe përmban procese si: mbledhjen e dokumenteve për identifikim, njohjen e fytyrës, fotografi për detektimin e ngjashmërisë dhe regjistrim në video, si dhe nënshkrimin elektronik të kontratave. Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen përfshijnë të gjitha dhënat e përpunuara për hapjen e llogarisë, si informacioni për identifikim, informacioni kontaktues, të dhënat me bazë dokumente, si p.sh., ngarkimi i fotos së letërnjoftimit apo pasaportës suaj.

Për të ofruar shërbimet përmes ofruesve të shërbimeve banka ofron hapjen e llogarisë në mënyrë digjitale nëpërmjet partnerëve të vet të besueshëm Fintech OS SRL që është përgjegjës për komponentët e integritetit dhe Onfido Limited së bashku me Namirial spa që janë përgjegjës për zgjidhjen SaaS dhe ofrimin e certificates së nënshkrimit elektronik për klientët. Marrëdhënia kontraktuale udhëhiqet nga marrëveshje shërbimi dhe që ka pjesë të saj edhe përcaktimet e lidhura me përpunimin e të dhënave dhe detyrimet për ruajtjen e konfidencialitetit.

## 7.1. Transferta me telefon

"Transferta me telefon" është një lloj transferte fondesh brenda bankës, e disponueshme për ju në kuadër të përdorimit të aplikacionit tonë. Në momentin që ky shërbim do të bëhet tërësisht funksional për klientët, ju mund t'u dërgoni para kontakteve nga telefoni juaj celular përmes Transfertës me telefon pa ditur të dhënat e tyre bankare nëse marrësi është gjithashtu një klient i Bankës. Për të kryer këtë shërbim, Banka përpunon të dhënat nga dërguesi dhe marrësi dhe transferimi mund të shihet dhe të listohet në historikun e transaksioneve të llogarisë.

Për të përdorur këtë lloj transferte, ju keni opsionin për të hyrë në kontaktet e ruajtura në pajisjen celularin tuaj dhe për të kërkuar kontaktin në fushën përkatëse Banka, sidoqoftë, mund t'ju kerkojë dhe t'ju duhet ta autorizoni atë kur dëshironi të përdorni Transfertën me telefon. Në këtë kontekst, përpunimi i të dhënave personale lejohet mbi bazën ligjore të interesave legjitime të subjekti të të dhënave.

## 7.2. Autentifikimi biometrik

Autentifikimi biometrik është një metodë opsionale e verifikimit e krijuar nga Banka për të hyrë në aplikacionin e Bankës ProCredit në celular. Është një veçori e shenjave të gishtave ose e njohjes së fytyrës që është projektuar, lëshuar dhe markuar nga Apple Inc. dhe Android respektivisht. Banka nuk do të ruajë autentifikimin biometrik në aplikacionin e saj dhe as nuk do ta mbledhë atë.

---

<sup>2</sup> Sipas kushteve të parashikuara në nenin 12-20 të Ligjit Nr. 124 Datë 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

Prandaj, banka nuk mund ta lidhë atë me informacionin personal që mban për klientët e saj. Banka mbështetet në pajisjen për të vërtetuar dhe konfirmuar/refuzuar verifikimin. Prandaj, Banka nuk përpunon të dhënat biometrike. Mund të aktivizoni/çaktivizoni këtë lloj autentifikimi në çdo kohë nëpërmjet aplikacionit.

### 7.3. Burimet Njerëzore

Për qëllime të burimeve njerëzore, ProCredit bank përpunon të dhënat personale të aplikantëve për punë, aplikantëve për praktika pune, punonjësve aktualë dhe ish-punonjësve.

Gjatë aktiviteteve të menaxhimit të burimeve njerëzore, të dhënat e mbledhura përpunohen në bazë të ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës për qëllime të tatimit, kontabilitetit, kushteve të sigurisë dhe të shëndetit në punë dhe qëllimet e sigurimeve shoqërore.

Të dhënat e përpunuara për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Të dhëna identifikuese si emri i plotë, data dhe vendlindja, mosha;
- Të dhëna kontakti si adresa e banimit, numri i telefonit dhe adresa elektronike (email);
- Të dhëna mbi arsimimin dhe përvojën profesionale, përfshirë historikun e shkollimit, trajnimeve, njohuritë gjuhësore dhe përkatësitë profesionale;
- Informacione të lidhura me pozicionin e punës, si titulli i pozicionit, funksioni, struktura organizative dhe vendndodhja e vendit të punës;
- Të dhëna të tjera, sipas rastit, që mund të jenë të nevojshme për realizimin e plotë të qëllimeve të menaxhimit të burimeve njerëzore.

### 7.4. Regjistrimet e thirrjeve telefonike

Kur na kontaktoni nëpërmjet telefonit, në numrin e Qendrës së Kontaktit apo në numrin që keni marrë nga banka për të marrë një kurs këmbimi, biseda do të regjistrohet për qëllime sigurie, për të garantuar cilësinë e shërbimit dhe si dëshmi për të mundur vërtetimin e kërkesave kontraktuale dhe për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimet. Për përpunimin e këtyre dhënave, Banka mbështetet në interesin legjitim sipas percaktimeve të ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Regjistrimet e telefonatave do të ruhen për sa kohë të nevojshme për arsye sigurie dhe provueshmërie, ne përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.

Nëse kërkohet, regjistrimet do të ndahen me autoritetet kompetente, në përputhje me ligjet në fuqi.

### 7.5. Setet e anonimizuara të të dhënave

Ne përdorim të dhënat tuaja personale për të përgatitur sete të anonimizuara të statistikave lidhur me ndërveprimin e klientëve tanë me produktet tona, në qëllim të përmirësimit të zhvillimit të produkteve, kuptimit të sjelljes së klientëve dhe vlerësimit të performancës sonë.

Ju nuk mund të identifikoheni si individ nëpërmjet këtyre sete të statistikave anonime, dhe prandaj nuk do të identifikoheni kurrë nga to. Ky proces bazohet në interesin legjitim sipas percaktimeve të ligjit "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

### 7.6. Mundësitë e financimit të gjelbër

Banka merr pjesë në Programet e Institucioneve Financiare Nderkombetare si psh.: EIF, EIB, BERZH, CEB, etj për të dhene kredi tek kredimarrësit e përshtatshëm për projekte të ndryshme si: për punësimin e të rinjve, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për investimet e gjelbërta, etj. Këto

institucione mund të kontrollojnë dhe përpunojnë të dhënat personale me qëllim të ofrimit të shërbimeve nën këto skema financimi.

Prandaj, Banka transferon të dhënat tuaja personale, pas marrjes së pëlqimit tuaj, tek institucioni përkatës, institucioneve partnere dhe/ose mbështetje tjetër partneriteti, si dhe Përpunuesve të të dhënave të tyre. Institucioni vepron si një kontrollues i pavarur i të dhënave dhe përpunon të dhënat tuaja personale në përputhje me Ligjin "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale".

## 7.7 Referimi i Klientit

Funksioni i referimit të Klientit, kur Banka e lejon të aplikohet, u mundëson klientëve ekzistues të bankës të ftojnë miqtë për të hapur një llogari duke ndarë kodin e tyre unik të referimit. Gjatë procesit të hapjes së llogarisë në menyrë digjitale, klientët e rinj mund ta fusin këtë kod referimi në një fushë opsionale "Kodi i referimit të mikut". Nëse si klienti referues ashtu edhe ai i referuar plotësojnë kushtet e pranueshmërisë së bankës, siç është aktivizimi i suksesshëm i llogarisë, secili do të marrë një bonus sipas kushteve të përcaktuara nga banka. Asnjë e dhënë personale e ndjeshme në lidhje me klientin e referuar nuk i zbulohet klientit referues.

## 7.8 Pagesat Contactless

Klientët mund ti përdorin kartat e tyre bankare, edhe për transaksione contactless në ATM si dhe për pagesa nëpërmjet platformave të ndryshme si psh: Google Pay dhe Apple Pay. Për të kryer këto pagesa klientët duhet të kenë kartë të regjistruar dhe të aktivizuar për transaksione pa kontakt, ku çdo transaksion i kalon një kufi pa kërkuar PIN. Ata janë përgjegjës për sigurimin e kartës dhe pajisjeve dhe duhet të njoftojnë menjëherë bankën në rast humbjeje ose vjedhjeje. Banka siguron mbrojtjen e të dhënave të klientëve dhe ofron mbështetje për çdo problem gjatë përdorimit të këtyre shërbimeve, duke respektuar rregulloret e privatësisë dhe sigurisë, si dhe kushtet e ofrimit të shërbimit nga këto platforma.

## 8. Cilat janë të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave?

Si subjekt i të dhënave, keni këto të drejta:

- E drejta për t'u informuar — Keni të drejtën të informoheni për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave tuaja personale, qëllimin e përpunimit të tyre, etj.
- E drejta për akses — Keni të drejtën për akses në dhe të merrni një kopje të të dhënave tuaja personale.
- E drejta për korrigjim dhe fshirje — Keni të drejtën t'i korrigjoni të dhënat tuaja personale të pasakta apo t'i plotësoni nëse nuk janë të plota, si edhe t'i fshini të dhënat tuaja personale, nën disa kushte të caktuara<sup>3</sup>.
- E drejta për t'u harruar — Keni të drejtën që t'i fshini të dhënat tuaja personale, nën disa kushte të caktuara, sipas kufizimeve të venodura në ligjin në fuqi.
- E drejta për kufizimin e përpunimit — Keni të drejtën të kërkonit kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja kur përpunimi është i paligjshëm, kur të dhënat e përpunuara nuk janë të sakta, kur kontrolluesit nuk i nevojiten me këto të dhëna.
- E drejta për transferueshmërinë e të dhënave — Keni të drejtën t'i merrni të dhënat personale tuaja, të cilat i mban Banka dhe t'i ripërdorni për qëllimet tuaja, si t'i ruani për përdorim personal apo t'i transferoni një tjetër kontrolluesi të të dhënave, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.
- E drejta për të kundërshtuar — Keni të drejtën të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale nga Banka, nën disa kushte. Për shembull, keni të drejtë që të kundërshtoni

<sup>3</sup> Sipas rasteve të përcaktuara nga ligji në Nenin 15 pika 2 të tij.

- përdorimin e të dhënave tuaja personale për marketing të drejtëpërdrejtë.
- Të drejtat lidhur me vendimmarrjen dhe profilizimin e automatizuar — Keni të drejtën të kërkonti nga Banka të mos jeni subjekt i vendimit të bazuar vetëm tek përpunimi i automatizuar, përfshirë profilizimin, për shembull, refuzimin automatik të një aplikimi online për kredi.

Banka do t'ju përgjigjet pa vonesë dhe brenda 30 ditësh pas kërkesës tuaj nëse vendosni të ushtroni cilëndo nga të drejtat e lartpërmendura. Megjithatë, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe numrin e kërkesave brenda një muaji, kjo periudhë kohore mund të zgjasë deri në 30 ditë të tjera, në çdo rast ju do të njoftoheni brenda 30 ditësh nga marrja e kërkesës, së bashku me shkaqet e vonës.

Në rastet kur nuk do të trajtohet kërkesa juaj apo do të refuzohet përmbushja e saj, ju do të informoheni për arsyet e mostrajimit ose refuzimit të përmbushjes së kërkesës, si dhe për mundësinë e paraqitjes së ankesës tek Komisioneri dhe padisë pranë gjykatës.

## **9. Çfarë janë kërkesat për akses të subjektit të të dhënave?**

Subjekte të të dhënave personale dhe të dhënave të tjera, të cilat mbahen nga Banka, kanë të drejtë të marrin informacionin e mëposhtëm:

- Qëllimin e përpunimit të të dhënave të tyre
- Rëndësinë dhe pasojat e këtij përpunimi
- Bazën ligjore të përpunimit
- Afatin e parashikuar të ruajtjes së të dhënave personale ose kriteret që përdoren për të përcaktuar këtë afat
- Kategorinë e të dhënave, edhe kur nuk janë mbledhur nga subjekti i të dhënave, dhe çdo informacion për burimin e këtyre të dhënave.
- Informacion për marrësin/it e të dhënave, përfshirë edhe marrësit në vendet e huaja ose organizatat ndërkombëtare dhe si sigurohet mbrojtja e duhur
- Ekzistencën e të drejtave sipas ligjit dhe të drejtën për ankesë te Komisioneri.

Ky informacion mund të kërkojë direkt përmes një kërkesë nga subjekti i të dhënave që bëhet tek personi përgjegjës për Mbrojtjen e të dhënave në bankë ose nëpërmjet email-it [alb.dpo@procredit-group.com](mailto:alb.dpo@procredit-group.com) ose [kos.dpo@procredit-group.com](mailto:kos.dpo@procredit-group.com). Banka gjithnjë do ta verifikojë identitetin e kujtqdo që bën kërkesë të subjektit para se të dorëzojë ndonjë informacion. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë nëse të dhënat e tij po përpunohen ose jo dhe të marrë një përgjigje, jo më vonë se 30 ditë nga kërkesa e tij.

## **10. Kur mund t'i transferojë Banka të dhënat tuaja personale?**

Banka mund të transferojë të dhëna personale te klientëve, palëve të treta, ku një transferim i tillë përfshin transferimin e të dhënave personale në agjencitë e Bankës, anëtarët e grupit ProCredit, auditorët e tyre të jashtëm, Auditorët e Jashtëm të Bankës ProCredit ose tek palë të tjera të treta që në mënyrë të ligjshme përpunojnë të dhënat tuaja. Klienti është në dijeni se të dhëna të caktuara personale duhet të transferohen në kompaninë mëmë të Bankës me seli në Republikën Federale të Gjermanisë për qëllime raportimi të konsoliduar dhe menaxhimi të riskut, apo edhe në palë të treta të tjera për qëllime të vlerësimit të riskut të kredisë, vlerësimit të riskut mjedisor, studime tregu, kerkime, anketa/analiza, promovimin e produkteve dhe shërbimeve, eventeve të bankës etj. Nëse ka një detyrim ligjor apo rregullator nga autoritetet publike dhe nga institucionet e tjera (si Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Tatimeve, Institucionet Tatimore Vendore dhe Qendrore, Drejtoria e Doganave, Agjencia e Inteligjences Financiare, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Shërbimi Përmbarimor Privat dhe Publik, Gjykata, Prokuroria, Organet Policore, etj.), Banka lejon përdorimin, administrimin e të dhënave të klientëve edhe nga këta institucione. Tek këta institucione përfshihen edhe Auditorët e Jashtëm të Bankës apo subjektet e tjera që bëjnë pjesë në grupin financiar ProCredit me qendër në Gjermani. Këtyre institucioneve iu lejohet që të përdorin të dhënat në atë masë që është e nevojshme dhe në çdo rast në zbatim të kërkesave të ligjeve specifike.

Banka mund t'ia transmetojë të dhënat tuaja:

- Autoriteteve: Autoritete mbikëqyrëse dhe autoriteteve rregullative si qeverisja lokale, Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë (BSH), AIF, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, IRS, apo institucione të tjera të zbatimit të ligjit dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.
- Përfaqësuesi juaj i autorizuar: Individët ose organizatat që japin udhëzime ose menaxhojnë llogari, produkte ose shërbime në emrin tuaj, si avokatë, ndërmjetësues, mbajtës të përbashkët të llogarive, debitorë solidarë, etj.
- Palë të treta: Entitete me të cilat Banka duhet të ndërveprojë për të mundësuar pagesa si psh: Mastercard si lëshuese e kartave të debitit/kreditit, banka tregtare, banka korrespondente, administratorë të bankomatëve, kompani që përpunojnë pagesa me kartë, përfituesit tuaj, SWIFT, SEPA, AIPS, AECH, etj apo institucione si: AAPSK, AIF, ILDKP, KPK dhe KPA, BKH, Prokuroritë, Gjykatat, etj.
- Institucione të tjera financiare: Anëtarë të Grupit ProCredit. Institucione kreditore dhe financiare që ofrojnë fonde garancie/ kredie për klientet e bankës, si Fondi European i Investimeve, Banka Europiane e Investimeve, EBRD, CEB, etj.
- Tek subjekte të licencuara në Shqipëri apo në vendet e BE-së për të kryer shërbime të verifikimit dhe të identifikimit në distancë për klientët e bankës (digital onboarding), në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm bankar, legjislacionin për shërbimet elektronike të besuara, etj.
- Të tjera: Kompani që ofrojnë shërbime për qëllime të përmbushjes së interesave legjitime ose detyrimeve kontraktuale, si këshilltarë ligjorë të jashtëm, noterë, kompani për vlerësimin e pronave, kompani sigurimi, auditorë, kontabilistë, kompani për arkivimin dhe shkatërrimin, kompani për ruajtje të të dhënave në cloud, ofrues të shërbimeve IT dhe të telekomunikimit, kontraktorë për zhvillimin e softuerëve, shoqëri postare, etj.

Të dhënat transferohen në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 124, datë 19.12.2024 "Për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale", dhe vendi ose organizata ndërkombëtare në fjalë siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave.

## **11. Cila është periudha për ruajtjen e të dhënave personale ose kriteret për përcaktimin e periudhës së ruajtjes?**

Periudha e ruajtjes së të dhënave personale varet nga kategoria e të dhënave dhe qëllimet për të cilat ato përpunohen. Në cilindo rast, të dhënat personale përpunohen për aq sa është e nevojshme që Banka të përmbushë detyrimet e saj për qëllimin për të cilin janë marrë të dhënat personale, ose ashtu si kërkohet nga kornizat e zbatueshme ligjore dhe rregullative.

Banka do t'i përpunojë të dhënat tuaja personale pas përfundimit të marrëdhënies kontraktuale për një periudhë që konsiderohet e nevojshme sipas kërkesave ligjore dhe atyre për dokumentacion. Për shembull, të dhënat personale që kanë të bëjnë me të dhëna për llogarinë mbahen për pesë vjet nga data e mbylljes së marrëdhënies së biznesit me klientin. Megjithatë për ruajtjen e të dhënave personale, zbatohen afatet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe në ligje të tjera (psh në ligjin për parandalimin dhe pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit).

Banka e arsyeton periudhën e ruajtjes në bazë të qëllimeve për përpunimin e të dhënave personale dhe është në përputhje me detyrimet ligjore për ruajtjen e të dhënave. Nëse të dhënat personale nuk kërkohen më, ato do të fshihen në përputhje me proceset tona të fshirjes/shkatërrimit ose do të anonimizohen.

## 12. Çfarë janë cookies?

Faqja e internetit të Bankës përdor cookies. Cookies janë skedarë teksti që ruhen në sistemin e kompjuterit përmes shfletuesit të Internetit. Shumë faqe dhe serverë në Internet përdorin cookies. Shumë cookies përmbajnë të ashtuquajturën "ID" të cookie. ID e cookie është një identifikues unik. Përmban një rresht me karaktere nëpërmjet të cilëve faqet dhe serverët e Internetit mund t'i caktohen shfletuesve specifikë të Internetit ku është ruajtur cookie. Kjo lejon që faqet dhe serverët e vizituar në Internet të bëjnë dallimin ndërmjet shfletuesve individualë të subjektit të të dhënave nga shfletues të tjerë të Internetit që përmbajnë cookies të tjera. Një shfletues specifik i Internetit mund të njihet dhe të identifikohet duke përdorur ID unike të cookie.

"Cookies" janë skedarë teksti të cilat janë dërguar në kompjuterin tuaj në mënyrë që ne mund t'ju njohin kur ju të na vizitoni përsëri. Ato shërbejnë për të bërë shërbimin tonë më të lehtë në përdorim, efikas dhe të sigurt. Ju mund të vendosni që shfletuesi (browser) i web-it t'ju njoftojë kur merrni një "cookie", ose të refuzoni përdorimin e tyre.

Faqet e internetit përdorin teknologjinë Google Analytics 4 (<https://www.google.com/analytics/>) me qëllim që të mbledhë të dhënat e vizitorëve për qëllime marketingu. Të dhënat e mbledhura nëpërmjet google analytics 4 nuk do të përdoren për të përcaktuar identitetin personal të vizitorit dhe nuk do të jetë e kombinuar me të dhëna të tjera personale që kanë të bëjnë me përdoruesin, nëse përdoruesi nuk ka rënë dakort më parë për këtë. Përdoruesit mund të kundërshtojnë në çdo moment mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të tyre.

### Cookies të nevojshme

Këto cookies janë të nevojshme që faqja e internetit të funksionojë si duhet dhe nuk mund të shkyçen në sistemin tonë. Zakonisht, këto cookies aktivizohen nga veprimet në kërkesat tuaja për shërbimet tona. Shembuj të këtyre veprimeve janë regjistrimit, plotësimi i formularëve ose përcaktimi i preferencave tuaja të privatësisë. Është e mundur që ta bëni shfletuesin tuaj t'i bllokoni këto cookies, mirëpo disa pjesë të webfaqes sonë mund të mos funksionojnë si duhet kur këto bllokohen.

### Cookies të performancës

Ne i përdorim këto cookies për të ofruar informacion statistikor rreth webfaqes sonë. Ato përdoren për përmirësimin e matjes së performancës. Kjo kategori njihet edhe si Analytics. Aktivitete si numërimi i vizitave në faqe, shpejtësia e ngarkimit të faqes, shkalla e refuzimit dhe teknologjitë që përdoren për t'ju qasur faqes sonë përfshihen në këtë kategori. Ne përdorim Facebook pixels për qëllime reklamimi.

### Cookies funksionale

Ne i përdorim këto cookies për të rritur funksionalitetin dhe për të mundësuar personalizimin, si bisedat në kohë reale, videot dhe përdorimin e medias sociale. Këto cookies mund t'i aktivizojmë vetë si dhe të aktivizohen nga ofrues të shërbimeve të palës së tretë, shërbimet digjitale të të cilëve i kemi shtuar. Nëse nuk i lejoni këto cookies, disa nga këto funksionalitete mund të mos punojnë si duhet.

### Reklamimi

Këto cookies aktivizohen përmes faqes sonë nga partnerët tanë të reklamimit. Këto cookies mund të përdoren nga kompanitë e palës së tretë për të krijuar një profil bazë të interesave tuaja dhe t'ju tregojnë reklama të përshtatshme në faqet e tyre. Ata e identifikojnë shfletuesin tuaj dhe pajisjen tuaj. Nëse vendosni të mos i lejoni këto cookies, ju nuk do të përcillen nga reklamimi ynë i targetuar në webfaqet e tjera.

#### 12.1 Çfarë lloj të të dhënave dhe informatave të përgjithshme mbledh Banka?

Banka mbledh një sërë të dhënash dhe informacionesh të përgjithshme kur përdor ndërfaqen një subjekt i të dhënave apo një sistem i automatizuar. Këto të dhëna dhe informacione të përgjithshme ruhen në

regjistrat e serverit dhe përmbajnë:

- Llojet e shfletuesit dhe versionet e përdorura
- Sistemin operativ që është përdorur nga sistemi i qasjes
- Webfaqet nga sistemi i qasjes ka arritur në webfaqen tonë (të ashtuquajturat "referues")
- Nën webfaqet
- Datën dhe kohën e qasjes në faqen në Internet
- Adresën e Protokollit të Internetit (adresa IP)
- Çdo të dhënë dhe informacion tjetër të ngjashëm që mund të përdoret në rast të sulmeve mbi sistemet tona të teknologjisë informative
- Përpunimin e të dhënave në komunikimin e informacionit

## **12.2 Përse Banka përdor cookies dhe mbledh të dhëna dhe informacion të përgjithshëm?**

Banka përdor cookies për t'iu ofruar përdoruesve të webfaqes shërbime me të mira, që nuk do të ishin të mundura pa cookies. Cookies mundësojnë që informacioni dhe ofertat në webfaqe të optimizohen duke patur në mend përdoruesin. Cookies po ashtu na lejojnë që t'i njohim përdoruesit e webfaqes. Qëllimi i kësaj njohjeje është që të bëhet më e lehtë për përdoruesit ta shfrytëzojnë webfaqen. Për shembull, përdoruesit e webfaqes që i lejojnë cookies nuk ka nevojë të regjistrojnë të dhënat për qasje sa herë që e vizitojnë webfaqen, sepse këtë funksion e merr përsipër webfaqja dhe cookie që ruhet në sistemin kompjuterik të përdoruesit.

Gjatë përdorimit të të dhënave dhe informatave të përgjithshme të lartpërmendura, Banka nuk nxjerr asnjë konkluzion për subjektin e të dhënave. Në fakt, ky informacion nevojitet për të:

- Menaxhuar përmbajtjen e webfaqes
- Optimizuar përmbajtjen e webfaqes, përfshirë reklamimin
- Siguruar qëndrueshmërinë e sistemeve tona të teknologjisë së informacionit dhe teknologjisë së webfaqes
- Siguruar autoriteteve të zbatimit të ligjit informacionin e nevojshëm për ndjekjen penale në rast të sulmeve kibernetike

## **12.3 Si mundën përdoruesit t'i menaxhojnë cookies?**

Subjekti i të dhënave mund të parandalojë në çdo kohë vendosjen e cookies nga faqja e internetit duke rregulluar cilësimet përkatëse të shfletuesit të Internetit të përdorur, dhe kështu mund të mohojë përgjithmonë vendosjen e cookies. Për më tepër, cookies që janë vendosur tashmë mund të fshihen në çdo kohë nëpërmjet shfletuesit të internetit ose programeve të tjera softuerike. Kjo është e mundur në të gjithë shfletuesit e njohur të internetit. Megjithatë, nëse subjekti i të dhënave çaktivizon vendosjen e cookies në shfletuesin përkatës të internetit, jo të gjitha funksionet e faqes në internet mund të jenë plotësisht të përdorshme.

## **13. Google Analytics**

Në webfaqen e vet Banka ProCredit ka integruar komponentin Google Analytics (me funksionin anonimizues). Google Analytics është një shërbim analitik në internet. Analitika në web është mbledhja, grumbullimi dhe analizimi i të dhënave në lidhje me sjelljen e vizitorëve në faqet e internetit. Shërbimi i analizimit në internet mbledh, ndër të tjera, të dhëna për faqen e internetit nga ka ardhur një person (i ashtuquajtur i referues), cilat nënfaqe janë vizituar, ose sa shpesh dhe për çfarë kohëzgjatjeje është parë një nënfaqe. Analitika në web përdoret kryesisht për optimizimin e një webfaqeje dhe për të bërë analizën kosto-përfitim të reklamave në internet. Operatori i komponentit të Google Analytics 4 është Google LLC. Me adresë, 1600 Amphitheatre Pkwy, Mountain View, CA 94043-1351, United States.

Për analitikën e webit përmes Google Analytics, Banka ProCredit përdor aplikacionin "\_gat.\_anonymizeIp". Me anë të këtij aplikacioni adresa e IP në lidhjen me Internetin e subjektit të të dhënave shkurtrohet nga Google dhe anonimizohet kur subjekti i të dhënave qaset në webfaqen tonë. Qëllimi i

komponentit të Google Analytics është të analizojë trafikun në webfaqen tonë. Google përdor të dhënat dhe informatat e mbledhura dhe ndër të tjera vlerëson përdorimin e webfaqes sonë dhe bën raporte online, që tregojnë aktivitetet në webfaqet tona dhe ofron shërbime të tjera që kanë të bëjnë me përdorimin e faqes sonë të Internetit për ne.

Informata të tjera dhe dispozitat në zbatim për mbrojtjen e të dhënave të Google mund të merren nga <https://www.google.com/intl/en/policies/privacy/> dhe Kushtet e shërbimit të Google Analytics Google Analytics shpjegohet më tej në linkun në vijim <https://www.google.com/analytics/>

#### **14. Përpunimi i të dhënave në komunikimin e informacionit**

Banka përdor email-e informuese, SMS informuese dhe njoftimet shtytëse (push notifications) për t'ju informuar rreth transaksioneve, tërheqjeve dhe informacioneve të tjera relevante për ju. Për disa nga komunikimet e informacioneve të tilla në vëzhgojmë dhe analizojmë sjelljen tuaj si përdorues me transaksionet ose tërheqjet e fundit vetëm nëse ky informacion është i rëndësishëm për efekt të kontratës ose brenda fushëveprimit të interesave tona legjitime. Në raste të caktuara banka mund t'ju kontaktojë edhe nëpërmjet telefonatave apo nëpërmjet inbox-it të e-banking dhe m-banking.

Nëse ju mendoni se privatësia juaj është cënuar, ju mund të paraqiteni në çdo kohë në një prej agjencive tona në adresat dhe oraret e dhëna në faqen e internetit, <https://www.procreditbank.com.al/shq/na-gjeni/>, mund të kontaktoni nëpërmjet numrit të telefonit +355 (4) 2 389 389 dhe në adresën elektronike [informacion@procredit-group.com](mailto:informacion@procredit-group.com) dhe [alb.dpo@procredit-group.com](mailto:alb.dpo@procredit-group.com). Stafi ynë do të jetë i gatshëm t'ju ofrojë asistencën e kërkuar. Nëse përdoruesit e faqes së internetit të Procredit bank Sh.A ridrejtohen në faqet e internetit të palëve të treta nëpërmjet lidhjeve të vendosura në të, Banka nuk është përgjegjëse për menaxhimin dhe politikën e mbrojtjes të të dhënave personale që aplikojnë palët e tjera. Kjo politikë privatësie nuk përfshin faqet e internetit të të tretëve.

#### **15. Përditësimet e politikës së privatësisë**

Banka rezervon të drejtën të modifikojë kohë pas kohe njoftimin e privatësisë në mënyrë që të pasqyrojë shërbimet e reja, ndryshimet në praktikën tona dhe çdo ndryshim ligjor dhe rregullator që mund të ndikojë në përgjegjësitë tona ndaj klientëve tanë.

*Ndryshimi i fundit i Politikës së Privatësisë daton më datë 30.07.2025*